

EQEREM CANAJ
OMBRELLA E THYER
TREGIME E NOVELA

BOTIMET TOENA

Falënderim



Botimi i këtij libri u mundësua nga Bashkia e Vlorës.

Falënderojmë bashkinë e qytetit të Vlorës, kryetarin e bashkisë, z. Dritan Leli, i cili si vizionar dhe patriot i devotshëm, së bashku me stafin për kulturën në mbarëvajtjen e punës së veprimtarive të larmishme, që mbulon ky institucion, i kushton vëmendje edhe letërsisë, librit artistik, si i vetmi dhe i pazëvendësueshëm në edukimin atdhetar dhe ideoestetik të brezave në Shqipërinë e sotme demokratike.

Mbi këtë këndvështrim, sponsorizimi i librit me tregime dhe novela “Ombrella e thyer”, një për zgjedhje e tematikës sociale, shpreh logjikën e tejpamësisë mbi njeriun e sotëm ndaj problemit të gruas shqiptare në vorbullën e aktivitetit të gjithanshëm.

Autori

EQEREM CANAJ

OMBRELLA E THYER

tregime e novela

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-376-18-3

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

*Fëmija pa prindin mbetet jetim,
kurse prindi për fëmijën jep jetën.*

E. Canaj

PËRMBAJTJA

TREGIME

Trëndafili.....	11
Shqiponja e Këndrevicës.....	17
Këngëvaji i mësuesit.....	23
Gruaja e mesarakut	31
Gishti i unazës.....	39
Jetvona	47
Kafka e thyer.....	55
Liria.....	66
Kundërçarja	80

NOVELA

Ombrella e thyer	99
Sytë e durimit Kosovë.....	172

TREGIME

TRËNDAFIL

Duhej të kenë qenë pushimet e prillit apo fundjava e zakonë, kur atë mbrëmje Bejazi la shëtitoren e zhurmshe, preu më të djathtë dhe çapiti drejt e në platformën e liqenit të shatërvanit të lulishtes. E mbanin për bukurosh, ndryshe edhe “trëndafil” e quanin biondinkat sykaltra të gjimnazit, pse qe djalë i gjallë, i drejtë gjer në prekje, syzi e fjalëmjaltë. Në mësim e ecte në vijën e mesit, por si njeri shkëlqente, prandaj thoshin dendur se atë do ta printe në jetë një rrugë trëndafilash.

Kishin mësuar se e ëma, djalin e vetëm, bej të bukur, e kishte lindur në vitin e zisë së të shoqit, prandaj edhe e quajti “Bejazi”, një ngushëllim kuptimplotë për një vejane që e adhuronte të birin sa edhe tokën, gurin, ujin. Dhe e kishte rritur si trëndafilin e kaltër buzë pusit të errët, deri në atë cak kohor kur që aty e më pas, do ta përmendnin “Trëndafili i zi”; fill asaj mbrëmjeje, kur gjëma ia zuri derën nënës gjoriane.

Ishte një çast i lemerishëm. E ndodhura e kusurit të linte mendtë e kokës, po qe se nuk do të gërmoje më thellë te sherrnaja mes shokëve të kursit; një grup ishte pro italian, duke trumbetuar zbarkimin e tyre si prurje të qytetërimit perëndimor, kurse kundërshtarët qenë veçse çika stralli në shqotë.

Atë pasdite Bejazi kishte marrë pjesë në demonstrimin popullor pranë portit të Skelës: ku një gardhim burrash, grash e të rinjsh në kundërshti ndaj të huajve, me anijet mizëri, po rëndonin gjirin e detit si asnjëherë tjetër: dhëmbë të shtrënguar, grushte e thirrma, si edhe të shtëna armësh, oshtima e të cilave ende ishte e gjallë brenda kafkës së tij të nxehur. Dhe donte ta bindte veten për anën e keqe të çështjes se këmishëzinjtë dukej se e kishin marrë kalanë nga brenda...

Me këtë mërziti ndër tru, ai hyri aty në atë park - lulishteje, të gjente qetësinë e munguar. Pra, i ra lulishtes kryq e tërthor, mandej platformës së unazuar të liqenit të shatërvanit të vdekur, sepse qysh se ishte vënë në punë, ndo dy-tri vite më parë dhe pati shtuar bukurinë e lulishtes, nuk funksiononte më; duar kalamajsh e dashakeqë të tjerë ia kishin prishur edhe tubat, që, me nxjerrjen e ujit vrull nga nëntoka, formonin trëndafila të bardhë, tamam në mbrëmje, kur hapeshin dritat e parkut të dukej se ndizej zjarr. Nën veprimin e rrezeve inkandeshente, trëndafilat e shatërvanit merrnin ngjyrë vjollcë. Kjo e pati bërë për vete edhe shkollarin. Megjithëse, tashmë loja e shatërvanit me trëndafilat e ujanës dhe detit të dritave nuk ekzistonte

kund, ai prapë kërkonte diçka të humbur në brendësi të asaj së premteje të prilltë, ku përfytyronte shatërvanin me trëndafilja gjithfarë lloji.

Ashtu, mendimhumbur, pasi bëri dy-tri rrotullime përqark veprës, e cila dergjej si grua në shtratin rrënimtar, ndjeu nevojën të ulej, ta shijonte ulur atë qetësi të mermertë. Dhe u ul rrëzë palmës së vjetër, e cila kishte flatruar qiellit, ku përfund saj priste stoli i kuq me një dërrasë mangët. I qetuar, ballë shatërvanit me liqenin e qelbur prej ujërave të ndenjura, ai ndiqte këngëvajin e bretkosave. Dhe, brenda vetes mallkonte heshtjen e atyre që drejtonin qytetin, e tha:

- Kur do t'i thërrasin ndërgjegjes për pak drejtësi, këta birko?

Ndërkohën e ndeshtrasheve “drejtësi - padrejtësi”, si i gjykonte ndër çast, ai vuri re se një grup prej tre-katër djemsh hynë shthurshëm në parkun e qetë. Njëri syresh që, si dukej, paskësh mbushur xhepat me gurë lumi të vozitshëm, merrte në shenjë abazhurët, që i jepnin dritë errësirës mbrëmësore. Pas të parit, sulmuan të tjerët... Llambadari kërciti me buçimë, drita dha shpirt. Pushtuesit e parkut morën vrull, ndoshta për të realizuar qëllimin final, duke mbjellë errësirën e gjithkahit.

Gjimmnazisti nuk e shtypi dot dhimbën, por u ngrit vrulltazi, i handakosur e mes tyre, bërtiti:

- Ç'bëni kështu, faqezinj?!

- Mjaft ti, kulish bushtre, ç'të hyn në punë? - bëri zë trimërorësh njëri prej tyre, të cilin e njihte si gjimmnazist, madje edhe bënte pjesë në përkrahësit e “këmishëzinjve”.

Bejazi, i revoltuar, zgjati duart për ta mbërthyer në fyt. Por u mjaftua, duke e goditur me grushtin e hekurt në fytyrë a ndofta në qelqin e syve. Kjo u duk pasi dashakeqi u tërhoq me vikamë, humbi mes errësirës. Dhe sulmuesi nuk kuptoi sesi një tjetër, i së njëjtës farë, e goditi po aq furishëm që prapa zverkut dhe, i ndodhur mes rrethimit, u mjegullua, gati të rrëzohej. U rrotullua ndër çast dhe iu përgjigj kundërshtarit me shkelmë mushke. Siç dukej shualli i këmbës ia plagosi kërcirin e ai ia dha ulërimës si qen i plagosur, kërbishtthyer dhe humbi në pellgun e tertë, kurse prishanakët e tjerë avulluan sa hap e mbyll sytë.

I sikletosur, tejet i rrënuar nga ajo shamatë aq e pakuptimtë, nervngut, u kthye te soli brinjëthyer. Donte ta qetësonte detin e mërzisë e për t'u vënë në rrugëtimin e prajit, që të zbardhte, në njëfarë mase rrënjët e gjasave idhnake, bëri të kujtonte rrugën e gjinisë, e cila dredhonte prej hershmërisë së largët. Flitej se dikur në një fshat malor, jetonte një nënë me një këmbë në varr që kur birin ia kishin vrarë për hasmëri. Pas një moti, ajo mblodhi nipërit, duke u vënë kushtin barbar të hakmarrjes që, sipas logjikës së ndezur të saj, pa plus - minuset, do të ishte: të gjendej “dora” (vrasësi) kudo ku ndodhej, të vritej pa mëdyshje dhe t'i silleshin asaj të dy krahët... Se pa ngrënë mish njeriu, ajo pas vdekjes do të ngjallej lugat. Të dy nipërit, pasi rrahën fshatra, rrugë, male e vërri, mandej ndër krahina e qytete, së fundmi e gjetën vrasësin dhe e çervetosën: ia prenë krahët që në shpatull, mbushën një trastë leshi dhe ia sollën.

Plakëzeza, pas kësaj, punoi qetësisht, i shqeu sërish krahët e sjellë, si të ishin kofshë dashi...

Teksa studenti bënte të vinte në peshore zënkën me prishamanët lëkurëzinj a këmishëzinj, nënqeshte me gjasat e vogla, se si njerëzit e lëshonin veten në atë mënyrë, duke ecur drejt fundkeqit. Ndërsa, që aty, dëgjonte detin tek tallazitej keq, lemerishëm, dridhës e tronditshëm. Nuk dihej... Shenja fatkeqësie ndofta përjetonte koha në të cilën ai, brezi i tij, jetonte. Edhe më çudibërëse i dukeshin minutat e asaj nate, kur mbi kurorën e qytetit ia jepnin kukujkat e pas tyre guguftutë do ta ndiznin parkun me zjarr dhembjeje e pikëllimi mjaftueshëm. Anijet e pushtuesit llokoçitnin në gjirin e Skelës...

Për një çast, ballë gjimnazistit u shfaq një trajtë njeriu, veshur me pelerinën e zezë të po asaj nate, pastaj edhe një i dytë, edhe... Dy duar të armatosura u zgjatën dridhshëm e tërbimshëm njëkohësisht:

- Ngriu, ore gdhe, e na dëfto trimëri! - zijoshi i parë kërcëlliu mes natës së zezë.

- Mooos, jooo! - viktima s'po arrinte të formulonte mendim të qartë.

- Ne do t'i dalim për zot e askush!

Dy pistoleta derdhën zjarr mbi djaloshin gjimnazist. Nga trupi, që u epua, se deshi të bënte këmbë përpara, buruan trëndafilatë të zinj gjaku, pjesa e vazhdës mbushi liqenin e verdhë... Deti ulërinte katakli, qielli filloi po ashtu të dridhej prej korbave të zinj të përtejdetit. Turma e ushtarëve

me thika ndër dhembë shkelën tokën e Perëndisë së Qytetit bregdetar.

Të nesërmen e atij mëngjesi gri, ndërsa përcollën për në qytetin e luleve trupin e heroit të tyre, vajzat gjimnaziste mbi përparëset e shkollës vendosën nga një trëndafil të zi. Qe, ky, akti i parë i shpalljes, i cili u ndoq në modë: zonjat e qytetit, nuset e vajzat, tash e prapa, në kostumet e veta, mbanin edhe nga një trëndafil të zi të së Premtes së zezë të pranverës 1939.

SHQIPONJA E KËNDREVICËS

Atë mot, dimri, si asnjëherë tjetër, në fshatrat e Kurveleshit pati derdhur borë të zezë, rrëfenin. Ajo flamë, çuditërisht e ngjyrosur, në fillim pati rrokur majëmalet e më pas, në ditënetët e qametit ogurkeq, pati pushtuar paq, një pas një, fshatrat malore si edhe fshatin e Seri Gurit. Në atë rrëzomë malesh, përfund këmbëve të gurta, tejet strallore, gjendeshin katër-pesë pëllëmbë dhé, por edhe zhavorrinë, ku njeriu mund të çapiste për t'u ngjitur në fshatin fqinj për hall jetese, gëzim a hidhërimi ose ndo hallexhi mund të ulej më bythë e të merrte paksa frymë për të vazhduar sërish më tej. Ishte “Fshati i qershive”, një udhëkryq nga ku lidhte dy krahina të rëndësishme, ndonëse i gurtë. Dhe i ndodhur në atë pikë të horizontit, ku bashkoheshin dy vargmale me kahe të kundërta, si dy koka deshësh me brirë kacorrë që, në zemërim e sipër, tërhiqeshin prapa, merrnin hov e sulleshin tërbimshëm ballë njëri-tjetrit, për të lënë kokën në pikëtakimin e përplasjes. Këtë shëmbëlltyrë të

jepnin malet ku ngrihej fshati që përjetoi, për herë të parë në jetën e tij, borën e çuditshme, ndërsa bujqit e paktë e vreshtarët e pikuar, me ato çikapikat e motit, e kishin bërë hallin dimëror: patën mbledhur misrat serikoje, arrat, fiqtë, bajamet, qershitë në kavanoza, prerë e sajdisur bletët, madje e ëma azgane e Seriut e kishte cytur të shoqin, që ta bluante edhe zahirenë e grumbulluar nga ajo pak tokë xebërishteje, sepse dimrit nuk i zihej besë. Dhe përfund dhomës së fëmijëve truponin dy thasë të çulltë, ai me rripa bardhezi, i cili qe mbushur me misër ose elb, tërshërë apo thekër, ndërsa tjetri me brezare të kuqe, kishte miell të bardhë, bluar taze, ashtu siç edhe dëshironte mëma e Seriut. Kështu, mendohej e veprohej në përgjithësi. Ndërkohë mbrëmja e katavasisë i pati vënë fshatit kapakun natar, siç edhe bënin fshatarët me kazanin e rakisë në vaktet e saj, sepse ishte kohë lufte, po prishej dynjaja, gjaku përskuqte dheun, se ish ngritur në këmbë populli, se qenë krijuar njësitë partizane, bij bujqish e barinjsh, qytetarë të mendjes e të dyfekut... Të gjitha e të tëra këto nuk ishin të panjohura për fshatarët e “Fshatit të qershive”, pse aty e kishin folenë edhe shqiponjat, edhe kukuvajkat. Dhe dimri po binte i zi. Dhe i gënjeshtërt e mashtrues po aq.

Fshati i vogël po mblidhej e shtillej me ethe në kurriz, ata të “syrit të pushkës”, duke rrëmbyer njëri-tjetrin, patën marrë arratinë për te partizanët, kishin zotëruar detyra e kishin bërë beli: dikush qe plagosur, dikush, rënë dëshmor i atdheut, dikush... Edhe këto i patën mësuar të mbeturit në

fshat: pleqtë, sakatët, gratë e fëmijët, si dhe Seriu fytyrëftua e sykaltër.

Përgjatë natës kureshtari vuri re ca gjëra të pazakonta, si: ati dhe e ëma komunikan mërzitshëm mes tyre, mandej u dëgjua kriza e derës së jashtme; i ati me dikë foli nëpër terr, nëna s'bëzajti. Pastaj heshtje, kuisja e qenit, lidhur në rrënjët e prallit të vjetër, pastaj gjëmime natore të herëpashershme. Mëma, trak! U ngrit nga shtresa e vjetër, mbuloi krahët e të birit, mandej u ul pranë oxhakut me pak zjarr, e çikëloi ngadalë atë dhe vazhdonte të dremiste me kokë ulur mbi hirin e druve që ngadalësisht digjeshin, ngrihej pasca, vërdallisej nëpër dhomë e fliste me vete fjalë të pakuptimta. Dukej i qe stërpikur gjumi i natës. Dhe djali i vogël përpiquej të binte në gjurmët e brengës. Edhe ai bëri të flinte e s'gjumonte dot. Për më tej, vulosi mendimin: dinte se kopenë e dhive e kishin në majëmal, në shpellën vjeshtake dhe... Por kishte dëgjuar, aq sa dëgjon një fëmijë, se gjermani po bënte një operacion hakmarrës të pashoq me barbarizmat më të papara. Dhe përpëlitej djaloshi, teksa përfytyronte mëmën në kthetrat e bishës. Kësisoj, i zuri mëngjesi: babanë te partizanët, nënën kërcure ndanë hirit, djalin kruspullosur si gërthja nën gurë.

Ballëdimri bëri turrin e hatashëm të të papriturave në fshatrat kurveleshase. Dhe ja se si. Pas erërave jugore, moti ndryshoi ndërkaq dhe majëmalet u bënë vezë. Ditë më prapa, sqotat sollën, kushedi nga ç'anë e dheut, re mjegullore dhe bora u bë e çngjyrtë, dëftonin të moshuarit se

çudia ishte shenjë fatkeqësie, çka pritej të ndodhte hataja... Barinjtë kokëfortë nuk u besuan dukurive, këmbëngulën në tekat se kush e kush të sfidonte motin. Po, pas borës, sulmoi patërshana natyrore, e cila derdhi që lart, nën çatinë e zemëruar, jo vetëm shi e breshër, por edhe gurë. Shpellat e rrëzomat morën rrokullimën. Në fshat mbërriti vetëm jehona e fundkeqit. I vogli i përjetoi këto çaste me ngashëri të qarash e britma kukurisjeje si gjithë bashkëmoshatarët e fisit.

Do të kalonin ditë - javë e muaj provash me përheqje ethesh, ku një ditë prej ditësh, edhe “Fshati i qershive” provoi dhëmbët e bishës. Gjermani përparoi gjer aty në fshatin e Seri Gurit.

Kur e kur, çamarrokët e fshatit do të vrullonin të shihnin mjegullën borane, që po pushtonte fshatin e tyre të gurtë, të parët vunë re gjarprin jeshil (ashtu u dukej) që po zvarritej teposhtë brinjës së rrëpirës. Dhe ngrinë. Fjalët ua përpiu grija mjegullore në atë të ftohtë brisk.

- Gjermanët! - theri zëri i Seriut.

- Mos janë tanët? - pyeti kushëriri i tij.

- Gjermanët... Kanë bërë pushkatime në “Bletaj”, “Memi”...

- Nuk dihet?!

- Të lajmërojmë!

- Të...

Një e qethur plumbash ua vrau fjalët sakaq. Veç fëmijët e trembur kuptuan të vërtetën. Dhe, pas kësaj, vrapuan

e u mbyllën nëpër shtëpitë të mëmat e drithëruara e të tjerë morën gërxheve në humbëtim. Ndërkohë, skuadra pushtuese, ndo njëzet e kusur burrash, të armatosur gjer në dhëmbë, zunë qendrën e fshatit të rrapi i madh, rrahën gjethet me breshëri të shtënash, vunë tellallë, bënë thirrje të dilnin në shesh: burra, gra, fëmijë... Për më tej, hynë ndër plevica e nxorën forcërisht njerëz të radhës, të mbetur fillikat a fëmijë që nuk ishin shkëputur dot prej mëmave. Nënokja e Seriu s'ia lëshonte krahun e dobësuar vogëlushit, i cili kërkonte të vërvitej në greminë të lumit. Po, kur numri i të grumbulluarve u shtur, ata i tërhoqën që aty e i nxorën në një ledh, ku bora ende ishte e pashkelur dhe i kërcënuan të tregonin... Ngaqë të gjithë tregoheshin gojëmbyllur, pushkatuan nja pesë fshatarë, trupat e të cilëve ranë mbi borë e gjaku i tyre mbuloi bardhësinë e ngrirë.

Seriu vuri re, ndërkohë, një burrë që, siç dukej, pasi kishte bërë plaçkitje ndër shtëpitë e shkretuara, pati ngarkuar e sjellë aty një thes me miell. Në një çast pushimi, përpara pesëshes së radhës që do të pushkatohej, burri hapi grykën e thesit, derdhi miellin mbi borë e mbi gjak... Po vogëlushi e njohu thesin me brezare të kuqe dhe bërtiti:

- Mami!... Mielli... Gjaku...

Gjermani vrastar e kapi klithën e çamarrokut dhe derdhi breshëri në erë. Ndër çastesh, Shqiponja e Këndrevicës, zbritur furtueshëm që nga gërxhet e borëzuara e mbi logun e limerit, lëshuar kthetrat mbi ata që përzielin keq borën, miellin e gjakun, rrëmbeu klithmëtarin e vogël e fluturoi

grykëmaleve. Dhe thoshin të tjerët (ata që i shpëtuan plumbit nazist) se gjermanët e patën përcjellë shqiponjën me breshëri të shtënash, ndërsa shpendi i plagosur, flatrathyer, me viktimën bashkë, qenkësh sosur gjallë në shpellën, ku ishte vendosur spitali partizan.

KËNGËVAJI I MËSUESIT

Mësuesin Leart Xhaferi e zuri dimri i atij viti në “Gjirin e Perëndisë”, fshatin më ekstrem të krahinës malore qendrore të Labërisë. Kur mbërriti aty, qe fillimvjeshte dhe fshati i vogël malor, me ata njerëz bujarë e gojëmjaltë, e priti krahapur dhe sipas tyre, ishte ai që mbante në dorë çelësin e diturisë. Në të vërtetë vjeshta ndo anë ishte e mirëseardhur për gjithkënd, veçanërisht për ata qytetarë, të cilët e ëndërronin fshatin. Kështu, pra, dukuria e parë për Leart Xhaferin ishte e mahnitshme: vargmale të çuditshme e qarkonin krahinën dhe e unazonin në kaltri, pse majëmalet qenë montuar në qiell. Përfund tyre qenë ulur këmbëkryq të lumurat fshatra, ku secili, me fanatizëm, ruante identitetin e vet.

Fshati e ftonte atë në çdo cak të asaj bukurie egrane: gjelbërim i harbuar, edhe pse ishte, si i thoshin ata kalemxhinjtë e letrave, vjeshta e artë, një lumë i rrëmbyeshëm, që buronte në rrënjë shkëmbinjsh, e ndante kaltrinë

stërmadhe në një vijë lakadredhë të bardhë, ku, më të majtë e të djathtë, gjendeshin shtëpitë e banorëve e, përfund, ledhet dhe rripnajat e tokave të bukës, pa harruar, gjithashtu, se zogjëria e dynjasë, dukej se qe grumbulluar e tëra aty dhe patën pushtuar asisoj pyllnajën e gjelbër, çdo lis, valanidh, ilqe, rrap a gjeth, pra qenë mbarsur me fluturakës shtegtarë, që të marramendnin me ligjërimet e pafundme, gjer në çmenduri. Sigurisht njeriu i mësuesisë kishte edhe boll gjëra të tjera, krahasuar me qytetin e rrëmujshëm e të mbytur në thashethemnajë, siç gjykonte si fillësë ai. Për shembull, era vjeshtake përzihej dendur me erëkëndin e frutave të pjekura të stinës, si shegët, mollët, rrushi i varieteteve të ndryshme, arrat, fiqtë, bajamet e lajthitë, pjeshkat, kajsitë dhe, sidomos, domatet e vjeshtës, të tjera e të tjera, pa përmendur drithërat bujqësore dhe grurënjat, që jepnin rendimentet më të lartat në zonën e buzëlumit.

Gjene, gjene, mësuesi i ri në vetvete, gjykonte: kjo pasuri kolosale, e krijuar nga krahët, djersa e mundi i pamat i brigadave bujqësore të kooperativës, e gjitha kalonte për shtetin... Dhe ata që e prodhonin zinin radhë në ato mikrodyqane për të marrë babanacen e misërt, që nuk e shponte dot as plumbi. Binte në trishtim dhe revoltohej, po aq me tmerr, kur i shikonte e dëgjonte skllëvërit e shekullit XX, teksa gjakonin duart me thirrjet “Rroftë diktatori”! Mandej, e mbyllte konceptin e tij mësuesi: këtë gjendje askush nuk mund ta ndryshojë, përveçse një përmbysje madhore... Pas kësaj, këtij nervi shpërthyes, kafshonte gjuhën fort, gjer në

përgjakje. Ashtu e pati porositur kusuremadhja mëmë atje në qytet. Dhe ashtu bënte.

Kohë më kohë, mësuesi nga qyteti po kuptonte nga jeta e bëmat e përditshme se fshatarët nuk ishin ata që dukeshin në të parë, por ajo pjesa e nëndukshme e tyre, e cila përbënte zgjuarësinë e lindur, pavarësisht nga shkollimi dhe kushtet e jetesës, si ulja në një sofër e të bardhit me atë me ngjyrë, të fismit, evgjitërinë, të mirin e të keqin... Kjo ishte tjetër apo gjëja e të tjerëve. Pra, jo pa farë kureshtje, ai u dha besimin, dashurinë e zellin, ndërsa kuptonte se edhe ata ia falën zemrën, siç edhe i kishin fëmijët e shpirtit. Në këtë mënyrë, ai ishte i pranishëm kudo: në festa familjare, shoqërore, në dasma fejesash a martesash, në grupime fshatçe e në çdo gjë. Dhe pati mësuar prej tyre atë që s'ia pati prerë mendja kurrë, fjala vjen, kishte përvetësuar të këndonte këngë labe, këngë trimërie, dashurie... Dhe, si i vëmendshëm që ishte, pati mësuar edhe të vajtonte me ligjërime si gratë dhe burrat labë, jo se Learti kishte zbritur nga qielli në tokë, por të qarët me llabane në kokë aty e mësoi, ndodhte asisoj, kur kishin të bënin me vdekje të rënda. Atëherë burri, porsa afrohej pranë portës së të dëmtuarit niste këngëvajin: hidhte llabanen në kokë, kaçupin a pallton, mbulonte kokën e i bënte hije fytyrës, që të mos i dukeshin lotët dhe ia drejtonte ca ligjërime në vargje, pra bënte këngëzezën, siç e quajti mësuesi këtë lloj riti të çuditshëm.

Nga sa tregonin gjasat për djaloshin e ardhur nga qyteti, ai shpejt u përshtat me jetën e fshatit, edhe pse punonte në

një zonë tepër larg, siç edhe thoshin, vendi ku hante pula strall, u bë një me ta, thuajse, mësues popullor. Po këtë sjellje, drejtori i shkollës e shikonte me syza të errëta. Dhe ishte e mundur, pasi atë që kishte ai të shkruar rreth të quajturës “biografi”, nuk e dinin fshatarët gjorianë, të cilët shikonin jo më shumë se dy hapa larg syve të tyre. Sidoqoftë, mendonte, hapi i tij duhej të ishte dhe të mbetej brenda kuadrit shkollor e prindërve të fëmijëve, dhe mbi të gjithë, të mos rëndonte më shumë bishti se sqepari. Prandaj, jo pa qëllim, në analizat mësimore, emri i mësuesit Leart Xhaferi ose do të kritikohet, ose nuk do të përmendej fare. Ishte koha, ndofta, kur spirali shënonte ngritje...

Si fillim, mësuesi i ri, fajësonte veten për shumë arsye, si: largësia, terreni i thyer e shkëputja nga qyteti, kur motet kërkonin kokë njeriu... Po dimri i radhës duket se ia vuri të dyja këmbët në një këpucë. Ashtu mendonte në netët e gjata kallkan, i mbyllur në një dhomë të vogël, - aneks i klasës, ku mblidhte kalamanët për mësim, të cilët i sillnin edhe nga një dru nën sjetull për oxhakun e mësuesit. Dhe, kur frynte e binte pa pushim, përroi i zi përkundrejt shkollës gjëmonte e i shkallonte trutë, dukej se nga çasti në çast, në ditë-net, ai përbindësh rrëmbimtar do të dilte nga shtrati e do të vinte përpara nxënës e mësues drejt lumit rrebelak, i cili ulërinte ndo dy-treqind metra larg shkollës. Kurse, në të tjera net, kur rrebeshi e tufani merrnin frymë e përtej tij ia grahte bora po me tërsëllëm, që aty nga shkolla e tij dëgjohej ulërima e turmave të ujqve, që arratiseshin dushqeve; mund të përfundonin edhe gjer te kolibja e mësuesit...

Duhej të qe ballë dimri, ajo që pruri gjasën e atij moti në “Gjirin e Perëndisë”, çka mësuesi Leart Xhaferi do ta regjistronte në vetëdijen e tij si më të pazakontën. Ndërsa u zbardhën nga bora majëmalet, barinj të e deleve e të tufave me dhi u djerrën në rrëzoma, në stallat dimërore ose ndër shpella, që përdorshin për këtë qëllim, sigurisht, ishin më pranë fshatit, dhe kështu u shkonin barinjve në ndihmë në momente të vështira, veçanërisht kur kërcënoheshin prej motit të keq. Një tufë dhiare e drejtonte Malua, bariu komunist, i cili mbante edhe përgjegjësinë madhore të mbarëvajtjes së gjësë. Fatkeqësisht, një mëngjes tufanesh, të ndjerin Malo barinj të e tjerë e paskëshin gjetur poshtë një gorrice dimërore, krahë e kofshë, as gjallë e as vdekur (që rrëzuar duke koqitur kokrra të mbetura ndër degë). Bënë si bënë të gjerët, e ngarkuan të sakatuarin në një mushkë, për ta shpurë gjallë në fshat, por i mjeri e dorëzoi shpirtin rrugës, pa mbërritur me frymë në dorën e mjekut të fshatit.

Ndërkohë, ata që kryenin transportimin e të plagosurit, u bënë edhe dëshmitarë të amaneteve të tij:

- Oh, vëllezër, mos më ka humbur dokumenti i partisë? - fliste e rënkonte Malua.

- Jo, e ke në xhepin e pasmë, mos u bëj merak, - e siguronte ai që i mbante krahun.

Ndërsa ecte monopateve të shtrembra, ulërinte dhembshëm dhe prapë:

- Si thoni, a do të më bëjnë hero? Unë rashë në krye të detyrës...

- Do të të bëjnë patjetër, - ia kthente ai që i mbante kërbishtin e copëtuar.

Sapo zbritën në buzë të lumit të turbulluar, bariu Malo dha fund, lumi jetor, që e pati përplasur në gjithkund: male, brinja e vërri, e pruri gjer në lirishtën që fshatin e kishte karshi. U hap lajmi i vdekjes së tij dhe kooperativistët i lanë punët e vrapuan në nderim - në përcjelljen e Malo bariut, që njëkohësisht ishte edhe xhaxhai i drejtorit të shkollës së Leartit, i cili kryesonte thujtë edhe partinë, edhe këshillin, edhe frontin, edhe...

Fshatarët, për çdo derë, rreth dhjetë ditët e para të pasvarimit, bënë ngushëllimin në shtëpinë e lumëmadhit, ku i priste e i përcillte vetë axha pikëllimtar dhe krenar njëkohësisht, pse Malua i kishte nderuar me aktin fisnik të rënies në krye të detyrës, një shembull i tillë që Partia domosdo do ta lartësonte, ashtu siç edhe shpjegonin dëshmitarët që bënë të ditur për amanetin e fundit... Në këto ethe përfshihej edhe mësues Learti, i cili, për këtë qëllim, u furnizua në qytet me një pako kafe e një shishe raki "Juniperus", që do t'i dorëzoheshin të helmuarit si dhurata harxhimi.

Dhe mësuesi përgjoi një pasdite, ku dimri rrihte vetëm majat e maleve, u vesh e u ngjesh, mendoi mirë fjalët e fjalitë që do të përdorte para zotit të konakut (drejtorit të tij), dhe për guximçastesh ia futi ndo dy-tri raki sa për nxehmje në barin e fshatit, pastaj mori shtegun. Kur mbërriti në oborr, kujtoi edhe një herë fjalët e arta që do të bënin punën e

duhur, hoqi pardesynë e zezë, e hodhi në kokë, si dëftonte zakoni dhe filloi ligjërimin: “Guri i rëndë në këto priqe,/ jetove si doje vetë,/ sa në fshat e sa në Ilqe,/ Malo, dheu qysh të tret?/ Astrit - gjarpri me pika,/ qysh t’u bë ajo pusi?/ Të vajti mendja për gorrica,/ qajnë zilet me ulëri”...

Ndërsa mbylli ligjërimin, mësuesi kuptoi shpërfilljen e të pranishmëve, si: e zonja e shtëpisë nuk begenisi t’i hiqte nga koka kapuçonin (pardesynë) dhe ta qafonte, t’i priste dhuratat e t’i shërbente kafënë... Jo vetëm kaq, por vuri re se si drejtorit nuk i qeshi fytyra aspak, përkundër, u nxi edhe më shumë dhe doli jashtë e s’u kthye sa që ai brenda. Vështroi në sy mësuesi ata tre pleq që po qëndronin vuv, të cilët, njëri pas tjetrit, ngritën supet të befasuar. Atëherë, edhe mysafiri u ngrit, bëri këmbë e u zhdruk në natën që nxinte. Ndërkohë, në rrugëzbritje ia dha edhe shiu me erën e rreptë malore, duke e bërë pulë të lagur e duke menduar thellë se ku drejtin pati shkelur në dërrasë të kalbur?!

Do të kalonin ditë dhe nga trysnia e gjasës mësuesi do të pësonte tkurrjen si të kërmillit, deri në mbrëmjen kur kallauzi i trokiti në derë të dhomës së heshtur, që ndriçohej nga një llambë vajguri, ku edhe mësoi realitetin e hidhur. U step e gjumë nuk vuri në sy. Drejtori qenkësh hedhur në sulmin e prapakrahëve që, kur e kur, kishte në dorë edhe gurin edhe arrën. Kishte ngritur partinë në këmbë dhe pati ndezur zjarr në kryesinë e këshillit të bashkuar se mësuesi Leart Xhaferi, ai dru i shtrembër, me biografinë zgjyrë, kishte dalë hapur kundër partisë (sillej për argument ligjërimi, këngëvaji për

Malon që nderoi fshatin)... E gjitha, sipas tij, ishte veç një ironi që therte njeriun e partisë, duke e përmendur edhe vargun ironik të tij. Ndërsa, pas diskutimeve të zjarrta, midis palëve, qenë hedhur mendimet mbi tavolinë. Dhe ishin mbyllur me vendimin përkatës...

Në një tjetër ditë, të një moti që nuk hapej derë, mësuesit e zonës u thirrën në një mbledhje të jashtëzakonshme, ku merrnin pjesë edhe drejtues të rëndë: të partisë, pushtetit, frontit, gruas, rinisë, si dhe nga çeta e pionierëve. Drejtori i shkollës foli gjatë për mësimet e Udhëheqësit... Ndërkohë, akuzoi mësuesin Leart Xhaferi si deviator. Dhe bëri të ditur vendimin: “Paralajmërim për pushim nga puna”. Për më tej, iu drejtua të akuzuarit:

- Leart Xhaferi, ke gjë për të thënë?

- Po, - foli në drithërim i pandehuri.

- Shprehu!

- Unë kam vajtuar sipas zakoneve të vendit... Këngëvaji, drejtor!

- Gënjën, ti ke bërë ironinë!

- Këngëzezën, - donte të sqaronte mësuesi, por nuk arriti, sakaq i ra të fikët. Ndërsa mbetën rreth tij vetëm kalamajtë, që e donin dhe e respektonin edhe si mësues, edhe si prind.

Dimri vazhdonte të ushtronte dhunë mbi “Gjirin e Perëndisë”. Po fshatarët sillnin ndër mend dhe bënë romuze me KËNGËVAJIN e mësuesit nga qyteti.

GRUAJA E MESARAKUT

Shkurti, si ndërmote në fshatrat e lumnajës, hyri me kllëç, me erë e me sqotë, me varfëri durimi dhe zdërhallet e gjithëkotit. Kështu, edhe në Mesarakun e bishtmalit. Pra, zbriti gjer aty, jo si muaji gusht, me urë zjarri në dorë, duke u vënë flakën pyjeve, gjethishtave, duke përvëluar, shkrumb e hi barin e thatë e të njomin bashkë, gjithsesi, ndryshe, i shkurtër e furtunë, pa shtuar, gjithaq, edhe hileqar, por për njerëzit, pra për ata që, gjithherë, ditë-net, në vazhdimësi e vënë veten në mësymje kundër natyrës për të krijuar të mira materiale për vete a për shoqërinë.

Mentari e pati thënë “shkurti shkurton urët”... Gjene, edhe gruas së Mesarakut, ndofta i kishin shkuar ndër mend të tilla të thëna e gjëma, si ajo “erdh jenari, erdhi behari”, të tjera e të tjera. Duhet t’i ketë thënë të shoqit, shkurti shkon shpejt, mandej vjen marsi i gjatë e punët, duke u shtuar, të marrin frymën, meqë e zuri hera shtatzënë, në mars sigurisht, do të qe më e rënduar, të shkonte ca ditë te prindërit në

përtej lumë... Dhe i shoqi, i ngazëllyer, pikërisht, se gruaja do t'i lindte edhe një vajzë pas djalit të vetëm, për t'i vënë pikë paskëtaj, natyrisht, nuk ia ka prishur. Kësisoj, e thënë, e bërë. Gruaja e Mesarakut fundjavën e bëri te prindërit, të cilët e mbajtën në pëllëmbë të dorës për njëqind e një arsye familjare, gati për një javë rresht, derisa bijës, sipas traditës fshatarake, i pati ardhur vakti për ta marrë i kunati e për ta kthyer në shtëpinë e nderit.

Atë mëngjes moti kullonte si rrobat e sapolara të vendosura në tel, se përgjatë natës pati rënë shi, madje edhe dy ditë më parë e njëjta gjë. Po nga ora pas dhjetës, qielli u kthjellua dhe dielli filloi t'i avullojë rrobat e varura mbi tel, rrugët i thanë pellgaçet me ujë; u bë një copë behar. Se, në lumnajë vendi, koha dhe njerëzit po ashtu, duket sikur, heshtazi, sigurojnë një marrëveshje të fshehtë përmes një mirëkuptimi të çuditshëm dhe aty për aty vendosen lidhje të brendshme moti, vendi, njeriu dhe ky i fundit merr vendime të shpejta. Andaj, thonë, kjo gjë ia ka zbardhur faqen njeriut lumëjan kaherë.

Kunati vrojtoi motin, iu dukën shenja të mira për udhëtim, fjala binte për te lumi, pasi delte nga shtrati e bënte përmytje, bëhej i pakalueshëm për në Mesarak. Koha e paqme kunetërit i vuri në udhë. Lanë prapa fshatin me ullinj, duke ecur njëri pas tjetrit, si dhitë e egra në shtigje shkëmbinjsh, mbërritën, ndaj drekë, në fushën e buzëlumit. Hoqën edhe këpucët e çorapet, zbathur, sepse dy ditë më parë lumi zemërak i shqotës së derdhur, e pati

mbytur fushën, duke lënë mbi tokë shumë baltë e llum. Kah gjendja, gruaja ndjeu se u leqendis, aq sa nuk arriti t'i rrëfente të kunatit se si në ato ledhe buzëlumi, në ato brezare, që dikur, në kohën e vajzërisë së saj, qenë ngritur me aksione vullnetare të të dy palë fshatrave, aty qe njohur e miqësuar me vëllanë e vogël të tij... Nuk arriti t'i shprehte asgjë, ndihej e rënduar, e plogështuar e rrëgjuar. Donte të ulej diku, edhe bohçja që i kishte dhënë e ëma, edhe çanta e dorës, plumb i bëheshin. Përsëfundi, gjetën një mezhdë dhe mbajtën frymën.

- Lart nga grykëmalet duket se po bie shi, - i foli i kunati.

- Oh, ku mali e ku jemi ne, - s'e çau fare asaj ane ajo.

- Po gjëmon gryka e Vjosës, shenja jo të mira, - pasoi ai.

- Nuk po bëhem mirë, - ndërroi bisedë gruaja.

- E ke nga sikleti i largimit, - ia mbylli shtegun e ankimeve ai.

- Vërtet, duhet të mendoj ndryshe: burri, djali, në këto dimra...

- Sidoqoftë, duhet bërë mendja top. Përtej lumit zien tjetër jetë.

- Eh, gruaja, leshgjatë e mendjeshkurtër, thonë.

- Ngrihemi, - preu i kunati, ai burrë zakoni e namusqar, i urtë e i drejtë sa te Zoti. Sa mendonte për punët e stinës, bagëtinë që e hanin të gjallë, kur nuk ua mbushte barkun. Pa lëre, kur ndodheshin në sezonin e pjelljeve. Toka, gjithashtu, qe shkretuar, të mbjellat i pati ngrënë lumi, vreshtat se pëlqenin përmytjen, shirat, gjithë të këqijat dukeshin se vinin prej motit të keq...

I lanë në bregun e tejlumit si të thënat e të bërat, morën në duar gjësendet e hynë në lumë, kunati përpara e kunata prapa. Ndërsa, ajo vinte re turpërisht barkun e fryrë dhe, rrufe, mendoj se fëmija së brendshmi, sapo uji kaloi përmbi gjunjë, do të ndiente të ftohtit. Pastaj kujtoi se si e pati mbështjellë dhjami i trupit të saj... Në fakt, ajo qe një grua normale: as e shëndoshë, as e dobët, bjondinkë sylarme e faqe shpuzë, me një fëmijë, që kishte lindur e rritur, mbahej si kumbull.

Gjene, sa ranë në rrymën e turbullt e të ftohtë, bënë edhe ca çape duke ecur, kuturu, me vështrim drejt fshatit, kunata, sapo ra në një thellinë, ulëriti, u kthye vrik kunati e i dha dorën, kuptohej se, që aty, u dreqos gjendja shpirtërore e të dyve. Ai i hodhi dorën dhe e rrëmbeu pas vetiu, siç rrëmbente pelën ndër rrugët qorre të fshatit. Po, tha, në dreq të vejë, mjaft të dalim gjallë përtej, pa uji i detit e llafet e fshatit s'kanë të sosur. Ndërkaq, u bë hataja, e cila nuk la vend për t'u menduar më gjatë, si kunati, si kunata: ndryshoi shpejt ngjyrimi i ujit të lumit, u kthye ngjyrë balte; as i zi, as i bardhë siç e kishte sojin. Po ky qe fillimi se, pas ca minutash, ia behu rebelia e dallgëve e cila, në një kohë mjaft të shkurtër, mbuloi gjithkahnë në murrëtinë gllabëruese, shtrati i lumit, jo vetëm që u mbush thembër më thembër, por llomotitja e dallgëve pati dalë përtej e përkëtej brigjeve anësore të atij dreq lumi, ndërsa, duke pushtuar kah të dy krahët, si majtas, si djathtas, pati krijuar një fushë llumbërtire të pamat, një det të murrmë që si kufi natyror

mund të mendoje se kishte të dyja fshatrat e përballta, të cilat qëndronin majë dy kodrave kokojka. Dhe, vetëm në atë çast, të mbyturve fshatrat iu dukën të bukura, të bardha a të gjelbra, por të paarritshme.

Ndër çast, nusja iu ankua të kunatit se turbullira e ujit i pati arritur gjer te mesi, se të ftohtët i kishte hyrë në palcë, se fëmija do të kishte vdekur brenda trupit, se i lanë duart edhe nga vajza që pritnin se... I kunati s'arrinte t'i thoshte asgjë, qe ajo bukuria dhe shtylla e shtëpisë, kur e kur, i shoqi pati marrë rrugët e Greqisë, djali, ylli i atij trualli, dyert e shkollave... Prandaj, prandaj... Ishte i detyruar të dëgjonte, të kuptonte a të moskuptonte të vërtetat e të pavërtetat e saj. Dhe, pas çdo fjale, frike a kudi çë, ai i thoshte: duro, edhe pak, edhe se lumi do të shterë e ne do të dalim përtej si molla. Por kish kaluar ora, kur patën zbritur në lumë dhe kishin ecur shumë pak, gati ndodheshin në mes të shtratit të lumit, madje të qorrollisur, pse dallga e rrëmbyer ua pati marrë mendtë, herë i shtynte përpara, herë prapa, herë poshtë e më thellë. Një moment, nuk po kuptonin as vendin, Mesarakun për karshi. Jo shumë larg, sipas hamendjes, vinte Vjosa, atje tek përziheshin lumenjtë, tallazitja bëhej e tmerrtë, domethënë, nëse dallga do t'i përzinte deri atje, do të qe veç fundi. E kujtoi ajo dhe bërtiti:

- Kunat, xhani, u rëndova...

- Hidhi plaçkat në lumë t'i rrëmbejë dallga e shtrëngohu fort pas meje!

- Të kam vëlla, - përbetoi ajo.

- Edhe unë, motër të kam, po shtrëngohu!

Ajo bëri si e mësoi i kunati, hodhi çantën e saj dhe ndoqi atë me sy se si e rrëmbeu dallga në çast e ia humbi tragën, pyeti prapë kunatin:

- Po bohçen?

- Ç'pyet më, hidhe, shpëto kokën!

- Po kam kekun e mëmës brenda...

- Hidhe edhe mutin, mos më lodh, shtrëngohu!

Me ç'kuptohej, kishin mbetur në të njëjtën pikë, mu në mes të lumit, pra, veç qenë rrotulluar, dallgët herë shtoheshin e bëheshin të tërbuara, herë qetoheshin një çast, vurduneja solli një rrap të shkukur kushedi se ku, po ua binte fare pranë. I thotë gruaja:

- Sikur ta kapim e mbase na nxjerr diku në breg.

- Në fund të detit, - ia mbylli gojën burri. Dhe, secili, vazhdonte me të brendshmet, jo hallet, po dertet. Kujtoi ai pleqtë që kishin zënë të dy shtretërit, nuk dinin se ç'po ndodhte. Kur të mësonin gjëmën, do të vdisnin, sepse me një këmbë në varr ishin. Pastaj u kujtua dhe i thotë të kunatës:

- Ti pate celular, të njoftojmë fshatin?

- E hodha, vetë më the.

- Hëm!

- Të të them një gjë, kunat?

- Nxire, ç'të duash thuaj!

- Ime më ka lindur shtatanike...

- Ç'domethënë?

- Se edhe unë...

- Nuk të kuptoj.
- Jam bija e nënës...
- Ruaju, po vjen patërshana dhe mbaju fort pas kockave të mia, - lajmëroi sërish ai.
- Më duket se do të lind?
- E, pra, të duket nga frika.
- Po më shtohen dhembjet, ndihem keq...
- Qepe gojën e shiko përpara!
- Nuk mundem...
- Mbylle grykën e thesit... Ka ardhur fshati, nuk e shikon?

Dhe fshati, ata të mbeturit, kushedi sesi i patën vënë re, lajmëruar njëri-tjetrin dhe zënë breglumin, po askush s'kishte mundësi t'u vinte në ndihmë, dallgët i kërcënonin e i sprapsnin gjithnjë tutje-larg, aq sa edhe zërat e tyre s'arrinin te të gozhduarit në atë mesarak dallgësh. Po, gjithsesi, të rrezikuarit, kur panë njerëzit përbuzë ujanës nxi, morën forcë durimi. Sidoqoftë, ndërkohë mendonin se ata diçka edhe mund të bënin në drejtim të tyre, paçka nusja, ajo farë llaçe, po hapte të tjera yçkla: do të lind, thosh, më ka ardhur në grykë, do të humbas fëmijën, do të humbasin tre vetë, o kunat...

Doemos, njerëzit s'mund të qëndronin sehirxhinj: patën lajmëruar kryetarin e bashkisë, Përparimin, deputetin, ai nga ana e tij pati vënë në dijeni prefektin e qarkut, mandej ministren e Mbrojtjes, dhe, në luginën e lumnajës u duk helikopteri; ajo shqiponjë e hekurt u ul përmbi lumë, po

njeriu i varur me shkallë fliste se nuk mundte të përqendrohej e të merrte së paku njërin e pastaj tjetrin. U bë rrotullimi i parë i helikopterit, i dyti dhe hiç. Në këto përpëlitje ethesh për jetë a vdekje të dy njerëzve, mbërriti një gomone, duke ecur tërsëllimshëm kundër rrymës. Dhe shpëtuesit e stërvitur u sulën mbi të rrezikuarit, i përflakën e i hodhën të dy në barkën e tyre të ftohtë e të lagur. Pas pak i nxorën në breg, ku i pritnin bashkëfshatarët, të cilët u dhanë teshat e tyre dhe u ndezën zjarr...

Ndërsa gruaja prapë nuk gjente qetësi, ulërinte e u shtri për të vdekur mu në zabel dhe në sy të njerëzve, që i gëzoheshin aktit shpëtimtar, asaj i plasën ujërat e lindjes e atëherë sërish u alarmuan ata të ushtrisë, të gjendjes së emergjencave dhe pas pak helikopteri i zhdukur u shfaq prapë në grykën e Vjosës e më pas në bishtmalin e gjëmës. I drejtuar nga zjarri i ndezur prej gjethishtave të rastit e prej britmave të fshatarëve, nëpërmjet shkallëve lëvizëse, u var specialisti, e mbërthyen allagrapa shtatzënë, ia vendosën këmbët në shkallët luhatëse, dhe e vunë në lëvizje, që t'i ngjitej shpejt barkut të shqiponjës së hekurt...

Mbi kokën e njeriut, që i jepte jetë e shpresë, u derdh shiu i kuq i gruas së Mesarakut. Poshtë tyre, rreth zjarrit që bubulonte, kryetari i bashkisë me të tjerë gallatonin e brohoritnin.

Shkurt, 2018

GISHTI I UNAZËS...

Në televizionin lokal u dha lajmi më i bujshëm për qytetarët, të cilët, qysh pas ndryshimit të sistemit nga diktatorial në atë demokratik, kishin përjetuar dhjetëra gjëzeza; nga të zakonat gjer te më përçudnueset, edhe prapë të tillën gjasë veshët e tyre nuk ua patën kapur kund: në fshatin malor, gjyshi ia pati prerë me sëpatë mbesës gishtin e unazës, ndofta me biçak, hanxhar nga ata që kasapët shqyenin mishrat e deshve, cjepve, demave, mëshqerrave apo derrave të varur në çengel. Ky farë mileti, kohë pas kohe, ç'nuk pati dëgjuar kah bëmatat ligane të njerëzve të shturur, të atyre tipave që dëftonin të pabëra, si: tregu i mishit të bardhë, ku një televizion radhe gjoja iu vu në gjurmim një soj rasti se diku në qytetin verior, një grup vajzash, të lidhura me kriminelët e “mishit”, shitën vajzën minorene dhe, gati për një vit e ca, mashtruan dhunshëm, gjer në turpërim, nënën e saj, duke deklaruar e shtjellë gjurmë të rreme se e gjora vajzë ishte parë aty-këtu, atje e

më tej, gjithë-gjithë, sepse me ngjarjen qenë lidhur ujqërit e Rendit... Ose, ose: rasti, kur dashnori i nuses pati vrarë edhe burrin dhe vjehrrën e, mandej i vuri flakën shtëpisë... Këto e dhjetëra gjasash të pakëndshme i patën mbërthyer, ballë ekranit televiziv, bashkëqytetarët e këtij të famurit qytet bregdetar.

Vargu i mynxyrave të kohës mjerisht ishte i pafund për Zani Bregun, gjyqtarin më në zë të qytetit. Aq shthuashëm e po aq beftë kishin ndodhur të tillat saqë, në të vërtetë, qenë tronditëse për gjithsecilin që i mbante veshët bigë për të dëgjuar vjedhjet e radhës, dhunimet e kusuret e dikujt a shumëkujt, plagosjet, vrasjet, varjet apo djegiet apartamentesh, sa në periferi, po aq në qendër. Të tillat, ndërsa përbënin shumicë apo vazhdë ligatinash, njerëzit, e ngrirë statujë para të nëmurave ekrane, mendonin, hë tani, hë pastaj, të dëgjonin emrin e dikujt të njohur, duke pritur ethengrirë se cilit i pati zënë derën e keqja pasuese. Ndërkohë, duke u mësuar me ngjyime dhimbjeje, çuditërisht, vetëdija njerëzore iu përshtat, mirë e bukur, duke pësuar një shurdhim tërësor e verbëror njëkohësisht: u pajtuan me sherrin, krimin, siç edhe mund të pajtohej njeriu me sëmundjen që e sëmbonte brenda trupit apo e gërryente përbrenda si lumi rërën. Dhe, atëherë, për ngushëllim, fshatarët thoshin: “E po të tijën e kishte, do të hajë edhe lumi e do të lërë edhe për ne”.

Kështu, edhe Zani Bregu, si shumica e qytetarëve, edhe pse mbahej e respektohej si nëpunësi ekstra i

drejtësisë, aq i theksuar ky kah konceptimi mbi gjendjen trazovaçe të qytetarëve, sa dukej hapur që deti shpirtëror i bashkëkombësve jetonte në prurje dallgësh të vazhdueshme dhe se anija jetë ekzistonte gjithnjë në hypje-zdrypje dallgësh pa mbarim e, duke qenë gjithherët në gjendje njësimi, nuk arrihej të kuptohej ndryshimi, shkurt vërehej se banorëve u pati humbur ndjeshmëria dhe gjendjet, dashuri-dhembje e anasjelltas, qenë zbehur gjer në pikën thuajse zero. Dhe këtë gjë të gjithë e kuptonin, po askush nuk hapte gojë: të veçantat u trajtuan në të përgjithshmet, të zakonat, në të radhës, në mos të parëndësishmet e qytetit.

Që mbrëmanet, Zani mësoi lajmëkeqin, e dëgjoji përsëri e sërish, domethënë, tri herë, pra bindshëm: ishte një krim i çuditshëm, jo nga pesha e makabritetit apo dhembjes, sepse, në fund të fundit, njeriu, pra mbesa e të quajturit “gjysh” nuk pësonte vdekje, madje, edhe ndërhyrje spitalore mund të mos kryhej fare, mbase një mjekim prej infermieres së fshatit e lumi hidhej në vaun e zakonshëm. Çështja, kësisoj, ishte hiçgjë. Kushedi në ç’lloj rrethanash qe ndodhur gjyshti ndaj mbesës? Për t’i dhënë një mësim për jetën, ai ia pati prerë gishtin, sipas fjalës së qëmotshme, po e përsërite prapë, ta këputa qafën!... Mirë, sikur të ketë qenë kështu, po e kundërta, e panjohura, pjesa nëndhetare, ajo që nuk dinte ai dhe as mund ta përfytyronte në çastet bujëmëdha? Pikërisht, në këtë pikë sharra ngecte në gozhdë. Dhe në mes të kësaj gjendjeje nervore, emërmiri gjyqtar luftonte sa me faktin, që thjesht i pati rënë në vesh, sa me ndjenjën

e sèkëlldisë, për aftësinë gjykuese, për thelbin e çështjes, si dhe për peshën e gjykimit popullor. Si do ta rigjykonin të tjerët, ata të paautorizuarit? Hej dreq, tha me vete, lajthitja para kohe ishte si gjëmimet në qiellin e kthjellët: ku ngjarja dhe ku Zan Bregu! Sidoqoftë, sidoqoftë, përsëriti ndër dhëmbë e u kthye me syrin e kujtesës të vështronte të tri mbeskat e tij, tek qeshnin e harliseshin me kukurizmat shkëlqimtare në buzë, sy, faqe e në flokët që ua rrëmbente era dimërore...

Ndaj mbrëmje të atij dimri egran, i cili, si asnjëherë tjetër, edhe pse në bregdet, prapë nuk pranonte dukuri zbutjeje, sipas shenjave, nëse nuk do të derdhte breshanë a borë, ndofta edhe gurë mund të rrokulliseshin që nga lart, dhe teksa, bënte të largonte paksa stresin, si i fiksuar, kthehej prapë te pika e fillimit. Në këtë mënyrë, nata e pati bërë tym. Krevati ia lodhi brinjët ca më shumë, ndërsa ia dha mendja e i telefonoi prokurorit për një informacion plotësues. Kur e kur, ai dallkaur ia ktheu “Mos u kruaj për trungun e lisit me miza”... Domosdo, i fyer, bëri tërheqje taktike dhe u mbulua kokë e këmbë me batanijen e leshtë, që ato mizat, të cilat ia përmendi kolegu, të mos i depërtonin kund.

Mëngjesi e zuri si mos më keq. Përgjatë copërave natore në të ftohtë, gati në të akullt, mërzitshëm e i grindshëm me vetveten e sikletinë kotare, i shfaqej ajo e flamura dorë e gjakuar, me ca gishtërinj të çuditshëm, teksa gishti i unazës lëshonte rrjedhë gjaku, për çka ai ndiente ligështimin deri në oshnuk të zemrës, herë kërcëlli e pakuptimtë. Pamja

shfaqte ankesë, domethënë drejtësi njerëzore, pika e dobët e qenies së tij, sepse të qenët shoqëri e kohës, kah plagosja e përditshmërisë, në ca raste kishte marrë trajtën e vuvit, pra edhe qorr, edhe shurdh. Gjithaq, e gdhira në qytet paskësh ardhur e çngjyruar nga e zakonshmja, as e grivtë, as e kthjelltë, po e bardhë. Qenë zbardhur pallatet, rrugët, trotuari qendror i qytetit, pemët dekorative, bustet e heronjve, Banka Kombëtare Tregtare, varrezat e dëshmorëve, Bashkia e kuqe e qytetit, si dhe xhamia me rrapin e moçëm pranë saj, e mbushur dëng me borë, degët që edhe ato zgjateshin si gishtërinj të stërmëdhenj në shëtitorën, që dukej se edhe ashtu zhurmonte nga kalimtarët, të cilët luftonin me bardhësinë e bardhë; gjithçkaja e tjetërsuar ia vrau vështrimin zhbirues atij dhe humbi në mjegullinën mëngjesore.

E çuditshmja e asaj dite dimri ishte se qytetarët, ata të cilët e njihnin dhe me të cilët komunikonte kaherë, të tjerë e të tjerë qenë marruar pas boranës, ndofta si e rralla herë që mbulonte vendin në të bardhë. Tymi mjegullor bënte trysinë e ngrirë të atij mëngjesi bregdetar. Mendoj se vetëm ullinj të vazhdonin të këndonin në përshkënditjen e rrymave, e prapë, gishtërinjtë e kurorave lakoheshin e ktheheshin sërish në gjendjen normale. Ndërkohë, iu shfaq dora e lënduar... gishti i unazës kullonte gjak... sëpata e ndryshkur... klitha lemeritëse e saj... gjyshi i egërsuar... Pastaj pala tjetër: babai, nëna, fisi... kryepleqësia e fshatit... operativi i zonës... televizioni publik, spikerja bukuroshe mbulonte pasqyrën e ekranit... Gjithë kjo mori njerëzish

në ngitje për një gisht dore. E çuditshme, mendoi prapë ai në të kundërt, të asaj që pati bluar mulliri i trurit prej kaq orësh. Mandej u shtang mu në mes të rrugës së borëzuar. Dhe e ktheu mendimin tek e para: nëse kishte një dashuri të pakushtëzuar, fare të pastër, ishte e vetmja marrëdhënieje, gjysh-mbesë. Nëse thyhej ky qelq, bota kishte krisur, parakupto përmbysjen: uji i zi dhe i valë do të pushtonte anekënd dherin.

Gjyqtarin e pati rrëmbyer makthi. Që nga shtëpia përfundoi në barin e preferuar, bar i qetë, disi luks dhe baristet - flutura të bardha, dy të tilla (në fakt, ai i përfytyroi jo dy, po pesë) i erdhën njëra pas tjetrës, komunikuan buzagaz e, pas pak, i sollën edhe kafënë ekspres, edhe fërnetin, të cilin e piu me të parën dhe porositi gotën e dytë e të tretë. Ishte ditë e ftohtë dimri e ai do të bënte si shumica e bashkëqytetarëve; ngrohjen alkoolike. Dhe, kur e kuptoi se kandari vajti në masë, u përshëndet me fluturat e bardha të lokalit, bëri këmbë e doli në bardhësinë e ngrirë.

Duhet të ketë folur me të përballurit ose jo, ndofta ndonjë përshëndetje e ftohtë me lëvizjen e kokës të qe e mjaftë, pse, në të vërtetë, Zan Bregu thajse prej gjashtëmbëdhjetë a tetëmbëdhjetë orësh, qysh se qe shfaqur ajo drama e dorës së lënduar, ai vetëm fliste me vetvete. Paçka, kush ia merrte për keq nëpunësit të drejtësisë? Asish, nëpër mjegull e tym, ai mbërriti te gjykata rreth orës dhjetë a përmbi, duke lënë prapa rrëmujëtinën e lodëtarëve (të vegjël e të mëdhenj) çmendurakë. Në theqafe, tha dhe la rrugën kryesore e iu drejtua zyrës: do të shfletonte disa dosje, që pritnin radhën e

të tjera, pse çdo ditë e re vinte me fytyrën e mosngjashmërisë, po kurrsesi nuk mbetej bosh, pa këmbë hallexhiu.

Gjyqtarit i bëri përshtypje fakti që përpara zyrës së tij qëndronte një grusht njerëzish. Iu dukën ca burra të shkurtër, madje sherrxhinj, pasi zërat çanin mjegullinën e borëzuar, frynte edhe erë dhe e përfshinte borën rrugore, si edhe atë që rrëzohej nga bimët dekorative. Ndërkohë, sekretarja e tij jepte e merrte me duar e të folur që t'i sqaronte, siç dukej, por ata shkurtabiqë thërritnin sikur fajin ia kishin ligjëbërësit a zbatuesit. Ndërsa ky u afrua, ata e prenë sherrin, i hapën dritë dhe, po ashtu, hynë fill pa i ftuar kush e ia ngulën vështrimin qenies së beftuar si t'i ngulnin në fytyrë pesë apo dhjetë gozhdë të ndryshkura. Dhe mjegulla e borës pati hyrë po aq shpejt e pati pushtuar mazgallat e gjithkëndit. Dhe në mjegull iu shfaq një figurë vajze e revoltuar, pastaj krahu i zgjatur i saj që u lëshua me rrapëllimë mbi syprinën e tavolinës: dora e gjakur... Brenda këtyre minutave xhuxhat nuk u dukën, sikur u zhbënë si figurina që i rrëmbente e i trazonte era borane. Ndër çast, si për t'u kumtuar hijen e autoritarit, ai iu drejtua sekretares hutaqe:

- Çfarë bëhet këtu?!

- Janë ata të ngjarjes monstroze të fshatit malor, - gjegji ajo.

Dialogu midis tyre nuk vazhdoi, pse ndodhi e llahtarta po aty. Sërish dora u bë e stërmadhe dhe gishtat e hakërryer u shndërruan në pesë njerëz, siç ishin më parë pranë derës së rrugës me borë. Ndërkaq, zërat e tyre pasuan paq. I pari:

- Zotëri, ne jemi katër djem dhe motra e lënduar, pesë, për të cilën edhe kemi ardhur në Shtëpinë e Drejtësisë.

- Edhe... Si është ngjarja? - i beftë Zani Bregu.

- Mbi motrën e vetme është ushtruar dhunë, - i treti:

- Atje ndër ne ha njeriu-njerinë dhe s'do t'ia dijë kush, - tha vetë e lënduara.

- Erdhëm te ju që të dëgjojmë zërin e ligjit, - i katërti.

- Unë nuk di gjatë: o nderin, gishtin e unazës së motrës, o gjaku "rrëke", - e mbylli më i vogli.

Gjyqtari u drodh. Donte t'i sikteriste jashtë me shkelma ata "xhuxhë" që po e nxehnin aq tepër në atë ditë të ftohtë dimri. Shporruni që këtej, deshi t'u thoshte. Po nuk e bëri, goja shprehu të tjera fjalë:

- E drejtë... keni të drejtë. Po vendi ynë jeton ethet e dimrit...

Ngaqë nuk mundte t'i përballonte dot më tej të acaruarit, i la në vend dhe vrulloi jashtë. Qielli ende vazhdonte të derdhte borë, ndërsa ai ecte çmendurisht, sepse prapa e ndiqnin me kërcënim ata që kërkonin drejtësi. Në mjegullinën e borëzuar dora e lënduar, gishti i prerë i unazës vazhdonte të derdhte pika gjaku. Gjurmët e kuqe mbeteshin mbi borë, nga kjo gjendje rrëqethëse a kushedi sesi, gjyqtarit iu ngatërruan këmbët dhe u rrëzua në hipinë e ngrirë. Po ato çaste, që nga veriu, në drejtim të të rrëzuarit, rrëshqiti një automobil i kuq. Dhe dha frymë mbi trupin e tij.

Vlorë, më 17.03.2018

JETVONA

Burrin e të dy deteve e thërritnin Armand Pari ose shkurt, Ari, si edhe e përmendnin ata që dinin të luanin, mirë e bukur, kalemin. Ky, Ari, paskësh jetuar mjaftueshëm, siç bënte llogaritë me vetveten, kur ndodhej fillikat, edhe pse ishte në krizë moshe. Gjithaq, si çdokush në këtë botë, kishte jetuar, paçka si guri në rrokullimë. Se, sipas tij, jeta e kishte parë me sytë e njerks: pas adoleshencës shkollore, e patën rrëmbyer çapkënlleqet e moshës, dashuriçkat e gjithëkotit, marritë e harrakatinave, mandej krijimi i familjes, lulëzimi i kthesave ndërkohore me lindjen e dy fëmijëve, djalë - vajzë, vdekjen e prindërve njëri pas tjetrit, vazhduar me ogurkeqin: humbjen e së ndjerës grua, çka do të bënte rrënimin fatal duke e prurë deri në atë pikë, gjersa, herë pas here, luste vdekjen, atë kapak të zi që mbyllte jetën dhe kaq.

Pas kësaj, gjëzemat në radhë, rrugicave të humbit, si: fëmijët do të shkolloheshin e punësoheshin në rrugët e jetës pa fund e krye, duke përfunduar në Amerikën e largët. Dhe,

si të tjerët. Kuptohet se do t'i mungonte, tekembramja, dheu nga duart e fëmijëve mbi shpinën e tij të përjetshme. Por, edhe këtu, nuk i vihej pikë, se dalkëshin gjasa të tjera e të tjera: ca dashamirë i kërkuan martesë me një të dytë, domethënë, të sërës, ku njëri ndër miqtë e pati cytur drejt aventurës, shto gjithashtu, të tjerë të cilët i afronin lënësja, siç i thoshin rëndom, pra me mendje të tallazitur e të rrahur dhallë. Kështu Ari i qytetit të dy deteve, kësisoj, s' ishte as në qiell, as në tokë, ndonëse jeta vazhdonte pa kthim prapa. Kur e kur, ai vështronte rrëzimin e vetes si avioni i plagosur. Veprimet e mëpastajme, nuk qenë veçse rastësore: të bjerë e koka gur, ose ku rafsha mos u vrafsha. Kështu, deri në atë ditë vere, teksa zbriti në plazhin e ri të qytetit e të sajdiste ditë gëzimmira si njëherë e një kohë të moshës së djalërisë, duke i dhënë tym mendimit: boll qe grenjur me trutë e tij, me ato "sikur ashtu e sikur kështu"...

Atë mëngjes, që duhej të binte aty nga ora dhjetë, pasi rrahu plazhin përbuzë detit që gjëmonte, tutje në thellësinë e pamat dhe përbuzë rrugës automobilistike, admiroi mozaikun femëror, tek theknin mishrat në skarë, përjetoj atë ndjesi të pakuptueshme: lirimin e njeriut të kohës dhe njëfarë egoizmi memec për atë që atij i mungonte e s' mund ta bënte. Gjithaq, e gjeti trivën e vjetër, bregpërroin që çante rërën e derdhte ujërat e trazuara në det, gjeti gjithashtu edhe kumbullën e vjetër të qëkurshmen (atëherë ai këpuste degëza gjithë lule të bardha, u merrte erë, mandej i afrohej ndonjë çupe - kumbull, ia dhuronte me mirësjellje)... Po, po,

kumbulla ende jetonte si Armand Pari me plagë trupi edhe ajo: një shalazqë i qe shqyer e tharë, ca xhufka, që i patën mbetur, mbanin në kurorë vetëm pak kokrra të verdha, të pjekura, sepse të tjerat, ngaqë askush nuk tregonte interes për të tillat, patën rënë në përruan që derdhte ujërat e qytetit. Dhe burri kusuremadh preferoi pikërisht bregun e përroit e të rërës, njëkohësisht, përballë kumbullës së vrarë nga rrufetë ndërmotore, së paku kështu mendoi, të shijonte fytyrën kaltri të ujanës, edhe për arsye tjetër se nuk donte të përzihej me gjysmën tjetër të njerëzisë, të lakuritur, të cilët shijonin ethshëm ato ditë të nxehta verore. Pra, u ngul siç ia dha truri: hoqi sandalet me nga një rrip lakuar, pantallonat jo të shkurtra, bëri vendin ku do të vendoste kokën e rënduar kah mendimet e trazuara, vuri syzet me xham të zi, si i vetmi luks apo dukuri e një plazhisti, u shtri në rërë ngeshëm, vuri të dyja pëllëmbët e duarve nën kokë, që t'i jepte mundësi vështrimit kaltëror të fushës së detit, pse një det me halle e përndiqnin, hap pas hapi; ra në meditim.

Ndër çast, sytë ia rrëmbeu një çadër në trajtë luledielli, kah e djathta e tij, e cila bënte të veçantën në morinë e atij plazhi që stërzgjatej midis ujanës dhe rrugës automobilistike e nën të qëndronte një grua vetmake e pikëllimtare (iu duk atij) e cila, hera-herazi, e godiste me vështrime vjedhurazi. Po Ari e kishte mbyllur atë shteg e nuk lidhi qen asaj ane. U kthye në të kundër, nxori një cigare dhe e pufi tërsëllishëm, u ngrit pas pak e bëri shëtitje të shkurtra përbuzë ujërave të kripura e rërës që po i përvëlonte shputat, pastaj i përllagu

ato, madje në kërcinj e poshtë, hodhi në det bishtin e cigares së djegur dhe u kthye sërish te vendi ku kishte zënë shtrojë.

Fakti i mosgjetyes, ku i la pantallonat, këmishën e sandalet njëripshe e befasoi, bëri të çuditurën e mbeti hutaq. Ndërkohë, zëri i gruas bionde me fytyrë të pikëlluar e cyti në qerthull:

- Zotëri, rrobat digjen në këtë zheg, - me gisht ajo i tregoi se teshat ia pati vendosur në skarën e çadrës luledielli.

Dhe Armand Parit iu qetësua tërbimi i caktut dhe u shpreh pa vetëdije:

- Me ç'të drejtë?! - ia nguli vështrimin në fytyrë dhe shtangu sakaq, teksa në pasqyrën e saj diktoi rrezëllinë e dhëmbit të florinjte...

- Thjesht, si njeri, si grua. Mos u vijasni, Ari, - bëri sqarimin e huaja, e cila i dheli emrin.

Telat bënë masë, shkëndijimet u hallakatën në ajër, deti ofshau në klithë. Pikëllimtarja ktheu gjoksin në dritë dhe ai peshoi gjatë qenien e saj, tepër gjatë. Kjo, pasi që a nuk që tamam Drita e pesëdhjetë vjetëve të shkuara, ndofta gjasi e rreme a realitet fatlum? Trutë e lodhur po sillnin turbullirën përrojeve ndërkohorë apo nga thellësitë e funddetit dilnin perlat mëngjeseve pranverore, teksa mjegulla zbret, rrëshqitur, ndaj majëmalesh deri aty e deti i dehur pllenonte, buzë rërës së njelmët, pikërisht të tillat?! Deti... Rëra zhuritëse... Mishrat e djegura, avull i ngrohtë... Çadra luledielli... Biondinka... Dhëmbi i florinjte... Drita!... Duke ia shmangur sytë gruas, që e thirri më emër, ose iu duk asish, ai bëri kundërshtinë, ktheu kokën andej nga